



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 21.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj– kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për trajtimin financiar, suplementar, të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe punonjësve që kanë punuar në metalurgji”.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Arben Elezi, Senida Mesi dhe Ismet Beqiraj.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Ambra Barova dhe Nikolin Staka.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Bashkim Sala - Këshilltar i ministrit të Financave dhe Ekonomisë

Astrit Hado – Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore

Astrit Kuka - Përgjegjës sektori në Drejtorinë e Punësimit dhe Aftësimit Profesional

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – ...të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit, si dhe punonjësve të metalurgjisë. Edhe për rekorde historike, duhet të theksoj që është hera e parë që bëhet një ligj integral, ku të tria profesionet e vështira përfitojnë konsiderueshëm nga trajtimi financiar dhe pjesa kryesore do të financohet nga buxheti i shtetit.

Për herë të parë, në logjikën e përftimit barazohen në trajtim profesionet e minatorëve, naftëtarëve dhe metalurgëve, në bazë të vështirësisë, duke përfituar secili nga profesionet nëpërmjet, le të themi, viteve bazë të përlllogaritjes në punë.

Ky është një projektligj me ndjeshmëri, për shkak edhe të kërkesave të përfaqësuesve të grupeve të interesit apo të industrisë dhe kategorive specifike të profesioneve të vështira, siç janë naftëtarët, minatorët dhe metalurgët.

Projektligji ka bërë një balancë shumë të kujdesshme të mundësive të buxhetit të shtetit dhe të përfitimeve që duhet të marrin të tria profesionet përtej kontributeve.

Gjatë referimit, do të përmend edhe se si i kanë të tria profesionet raportet e rëndësishme midis kontributeve dhe përfitimeve. Do ta krahasojmë këtë, që ta kuptojë edhe publiku se çfarë po bëjmë dhe me sa maturi po e trajtojmë çështjen në favor të naftëtarëve, minatorëve dhe metalurgëve. Unë do të tregoj me detaje, së bashku me kolegët e mi të komisionit, edhe raportet specifike mes përfitimeve dhe kontributeve ndër vite.

Kemi të ftuar në komision zëvendësministrin, zotin Elton Haxhi, këshilltarin e ministres së Financave, zotin Bashkim Sala, drejtorin e ISSH-së, zotin Astrit Hado, si dhe zotin Astrit Kuka, drejtor në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Do të procedojmë me fjalën e përfaqësuesit të ministrisë, me referimin tim dhe më pas do të kalojmë te pyetjet dhe komentet.

Sot do të mbarojmë me miratimin në parim dhe nen për nen, sepse ky projektligj është kërkuar nga Këshilli i Ministrave me procedurë të përshpejtuar dhe të enjten do të jetë në seancë.

Faleminderit!

Zoti Haxhi, keni fjalën.

Elton Haxhi – Faleminderit, kryetar!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka hartuar një projektligj për trajtimin financiar suplementar për profesionet e vështira dhe shumë të vështira, të minatorëve të nëntokës, punonjësve të naftës dhe gazit, si dhe metalurgëve.

Ky projektligj është një trajtim financiar shtesë për këto profesione. Përfshirja në një ligj i tri profesioneve të vështira është bërë për shkak të ngjashmërisë me vështirësinë e punës dhe brenda këtij parimi janë bërë dallime, në punë të vështira dhe shumë të vështira.

Ligji aktual për statusin e naftëtarit fillimisht u projektua me 5000 përfitues. Futja në status edhe e punonjësve të industrisë mekanike të naftës dhe administratës së ndërmarrjeve të naftës e deformoi thellësisht çështjen e statusit, duke e trefishuar numrin e përfituesve.

Përveçse sasior, deformimi është edhe cilësor, sepse favorizon punonjës të industrisë mekanike, shërbimeve administrative, që nuk klasifikohen ligjërisht si punë shumë të vështira apo të vështira, ku hyn minatori nëntokë, naftëtari dhe metalurgu, si tri profesione të këtyre kategorive, që sapo i përmendëm.

Duke analizuar vështirësitë e punës së profesioneve dhe kushtet e vështira të punës, u mendua që tri profesione të vështira dhe shumë të vështira të trajtoheshin në një ligj të përbashkët për trajtim financiar shtesë. Arsyeja përse duhen trajtuar me përfitim shtesë, ka të bëjë me vështirësinë e punës së tyre, periudhën e shkurtër të punës për shkak të vështirësisë dhe pamundësisë fizike për ta vazhduar punën, kohën e gëzimit të pensionit, si dhe jetëgjatësinë e këtyre kategorive.

Projektligji i propozuar përcakton saktë punët e vështira dhe shumë të vështira në naftë, miniera dhe metalurgji, që do të trajtohen duke garantuar trajtim të barabartë, bazuar në vështirësinë e punës; përjashton nga përfitimi kategoritë që janë përfshirë pa të drejtë në statusin e naftëtarit, pa punuar në naftë; trajton në mënyrë të drejtë, me shtesë pensioni, të tria kategoritë, duke mos krijuar diferenca midis kategorive, pasi këto shtesa janë të financuara nga buxheti i shtetit dhe nuk lidhen me kontributet e paguara.

Ky propozim shpërblen pensionistët aktual dhe pensionistët në vitet e ardhshme deri në një moment të caktuar, duke e bërë këtë skemë të përkohshme. Përkohshmëria e kësaj skeme lidhet edhe me faktin që këto industri tashmë janë të privatizuara, menaxhohen privatisht dhe buxheti nuk mund të financojë me paratë publike përfitime shtesë, jokontributive, që lindin nga puna e paguar nga sektori privat.

Në përfundim, dua të theksoj se në mbledhjen e fundit të Këshillit Kombëtar të Punës, përfaqësuesit e sindikatës së minatorëve, naftëtarëve dhe metalurgëve, bënë vërejtje për zvarritjen e miratimit të këtij ligji, i cili është përkrahura prej tyre disa muaj në vijim.

Në përfundim, për të përmbledhur efektet e këtij ligji, përfitues llogariten 13 mijë e 300 minatorë, 7600 naftëtarë dhe 2500 metalurgë, duke e çuar numrin total në afro 23 mijë e 400 përfitues, që llogariten të përfitojnë afërsisht një shpërblim në masën e konventuar 14 milionë dollarë në vit.

Ekipi që më shoqëron është këtu për t'iu përgjigjur bashkë me mua pyetjeve apo vërejtjeve që do të kenë anëtarët e komisionit. Kështu që jemi të hapur për çdo diskutim.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Haxhi!

Duke qenë se komisioni më ka caktuar detyrën e relatorit, edhe për një shkak praktik, sepse ligji është punuar në kohën kur unë kam qenë në detyrën e ministrit të Financave, së bashku me Astritin, Astritin tjetër, zotin Bashkim dhe gjithë Institutin e Sigurimeve, do të kem një relativitet të gjatë (do t'ju kërkoj ndjesë për këtë), më tepër për shpjegime ndaj të gjitha kategorive, për përfaqësuesit e opozitës, që kanë shprehur interes, si dhe për shkak se këtu në komision kemi një anëtar të nderuar nga profesioni i naftëtarëve, Ismetin, një njeri me shumë kontribute në këtë sektor. Mbi të gjitha, kjo çështje është sensitive dhe praktikisht dua që publiku ta kuptojë se ky është një premtim i mbajtur nga qeveria për të tria profesionet: naftëtarët, minatorët dhe metalurgët.

Për hir të së vërtetës, Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste ka këmbëngulur në vazhdimësi për një projektligj të unifikuar. Praktikisht, sot bëhet realitet premtimi, që e ka bërë vetë Kryeministri dhe qeveria gjatë fushatës elektorale.

Siç e theksova, projektligji sjell tri risi të rëndësishme.

Risia e parë është përfitimi suplementar për të tria profesionet, të cilat do t'i detajoj në vazhdimësi.

Risia e dytë është përfitimi shtesë mbi pensionin e pleqërisë për të tria profesionet, duke iu referuar viteve të marra si bazike në përlllogaritjen e vjetërsisë në punë, me 1% dhe 0,6% për naftëtarët. Kjo do të thotë se 12,5%, pra nga 9-12,5%, është shtesa për çdo kategori.

Risia e tretë është detyrimi ligjor për të krijuar skemën suplementare nëpërmjet kompanive private, sepse industria është private, në mënyrë që ata nën moshën 48 vjeç të kenë mundësi të përfitojnë nga fondet e vetëkrijuara me kontribute të detajuara në legjislacion, pasi të kenë mbushur moshën e pensionit, në rastin konkret, në qoftë se duhet të dalin në pension të parakohshëm, duke iu referuar moshës 55 vjeç për minatorët dhe 60 vjeç për naftëtarët.

Ky projektligj, siç e theksova, ka për qëllim të mbulojë me përfitim para kohës së mbushjes së moshës për pension, të japë përfitime shtesë mbi ato që akordohen nga ligji bazik nr. 7703 i vitit '93, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", për tri kategori mjaft të veçanta punonjësish, të cilët kanë punuar në miniera nëntokë, në industrinë e naftës, në punë me një shkallë vështirësie shumë të larta, në metalurgji, si dhe dhënien e një përfitimi shtesë mbi pensionin e pleqërisë për të gjithë pensionistët aktualë në këto profesione.

Përfshirja e tri profesioneve të vështira në një ligj është bërë për shkak të ngjashmërisë me vështirësinë e punës. Brenda këtij parimi janë bërë dallimet në punë të vështira dhe shumë të vështira, duke iu referuar në çdo rast kategorizimit të vendimit nr. 526.

Nuk është rasti i parë që një ligj hartohet për disa kategori të ndryshme punësh, por me karakteristika të ngjashme, që adresojnë problematikë të njëjtë.

Mund t'ju sjell si shembull rastin e përfitimeve suplementare për ushtarakët, policët, punonjësit e Shërbimit Informativ Kombëtar, të Policisë së Burgjeve, Gardës së Republikës, zjarrfikësve, që kanë statute të veçanta. Këto grupe, megjithëse kanë ligje dhe status të veçantë organizimi, për sa u përket përfitimeve suplementare, trajtohen me një ligj.

Për minatorët janë parashikuar kushte lehtësuese. Konkretisht, mosha e daljes në pension e minatorëve është 55 vjeç ose 10 vjet para moshës ligjore të daljes në pension, sipas ligjit të sigurimeve shoqërore. Ky është një premtim i mbajtur kjo maxhorancë.

Naftëtarët dhe metalurgët dalin në pension 60 vjeç ose 5 vjet para moshës ligjore të daljes në pension, sipas ligjit të sigurimeve shoqërore.

Këtyre kategorive u konsiderohet pensioni i plotë me 30 vjet punë për burrat dhe 25 vjet për gratë, ndërkohë që për të gjithë shtetasit e tjerë vjetërsia në punë, për të përfituar pension të plotë, është 37 vjet dhe shtohet 4 muaj çdo vit, deri kur të bëhen 40 vjet.

Dua të ndalem pak në aspektin e lehtësimit të konsiderueshëm për shkak të vështirësisë së punës, duke iu referuar premtimit të mbajtur nga kjo maxhorancë.

Për të gjitha profesionet e tjera duhen 37-40 vjet punë, ndërsa për këto profesione duhen 30 vjet punë për burrat dhe 25 vjet punë për gratë. Pra, ka një diferencë prej 10 vjetësh lehtësim, që është lehtësimi i parë dhe një premtim i mbajtur.

Gjithashtu, dua të theksoj se është parashikuar që me plotësimin e moshës ligjore, sipas ligjit të sigurime shoqërore, këta pensionistë do të marrin një shtesë mbi pensionin. Minatorët do të marrin 1% të pensionit të pleqërisë për çdo vit pune, pra, përveç trajtimit suplementar të nëntokës, kurse naftëtarët dhe metalurgët do të marrin 0,6% të pensionit për çdo vit pune në këto profesione. Vlen të theksohet që ky përfitim shtesë nuk është i bazuar në kontribute, por është pagesë e drejtpërdrejtë e buxhetit të shtetit dhe e tatimpaguesve shqiptarë në favor të këtyre profesioneve. Ky është një premtim tjetër i mbajtur i kësaj maxhorance.

Duke u bazuar në vjetërsinë minimale në profesion për të përfituar këto trajtime suplementare, minimalisht minatorët do të përfitojnë shtesë 12,5x1%. Të njëjtën gjë do të përfitojë edhe pjesa tjetër e profesioneve për shkak se baza është 20 vjet me koeficient 0,6%. Pra, siç e shikoni është barazuar përfitimi shtesë për shkak të vjetërsisë së punës. Të tria profesionet janë trajtuar të barabartë, megjithëse vështirësitë nuk janë të njëjta. Vështirësitë jo

të njëjta reflektohen në numërimin e vjetërsisë bazë për shkak të llogaritjes. 12,5 vjet minatorët, 20 vjet metalurgët dhe naftëtarët.

Pra, nga dalja e parakohshme në pension dhe shtesa mbi pension këto kategori përfitojnë 20% më shumë se para këtij projektligji. Ky është një premtim i mbajtur për të gjithë ata që janë të interesuar për politikën sociale të kësaj qeverie. Nga dalja para kohe në pension dhe shtesa mbi pension këto kategori përfitojnë 20% më shumë se para miratimit të këtij projektligji. Kjo është shumë e rëndësishme për ta ballafaquar me grupet e interesit dhe kategoritë e profesioneve që, natyrshëm, edhe mund të protestojnë në të drejtë të tyre.

Në terma absolutë, pensionistët aktualë, referuar pensionit mesatar të minatorëve prej rreth 23 mijë lekësh, vetëm nga ky projektligj do të përfitojnë rreth 2900 lekë në muaj. Për pensionistët e rinj si minatorë, kjo shtesë do të jetë rreth 1400 lekë në muaj, kjo për shkak të uljes së vjetërsisë për të dalë në pension të plotë nga 37 vjet në 30 vjet. Pra, ky është një tjetër premtim i mbajtur nga kjo maxhorancë. Për pensionistët aktualë që kanë punuar në naftë kjo shtesë shkon në masën 2900 lekë, kurse për ata të rinj që hyjnë në sistemin e pensioneve do të jetë 1400 lekë. E njëjta llogari vlen edhe për metalurgët.

Përfitimet e këtij ligji bazohen në vështirësitë specifike të secilit sektor. Sipas vendimit nr. 526 të vitit 1958 për kategorizimin e profesioneve, minatorët e nëntokës hyjnë në kategorinë e vështirë të punës, pra, në kategorinë e parë, kurse naftëtarët dhe metalurgët klasifikohen si punë me vështirësi të kategorisë së dytë. Kjo konfirmohet edhe nga niveli i pagave të përcaktuara sipas shkallës së vështirësisë para vitit 1994, në referencë të vendimit nr. 526. Pra, paga e naftëtarit ka qenë sa 78% e pagës së minatorit të nëntokës, kurse e metalurgëve ka qenë rreth 81% e pagës së minatorëve të nëntokës. Pra, puna e minatorit të nëntokës është konsideruar më e vështirë dhe prandaj kemi bërë edhe atë lehtësim të madh në vjetërsinë e punës me 12,5 vjet dhe me 1% shtesë për vjetërsi pune mbi pensionin aktual.

Këtu kam nevojë që ju si anëtarë komisioni, media dhe të gjithë ata që na ndjekin të kapin thelbin e asaj që po bën qeveria me këto 3 kategori. Përfitimet që marrin dhe shtesat që parashikohen për këto kategori bëjnë që koeficienti i kthimit të kontributeve që llogaritet si raport i përfitimit të marrë ose që do të merrte me kontributet e paguara ndër vite të njehsuara është 340% për minatorët. Do të thotë se për 1 lek kontribut, marrin 3,4 lekë përfitim, kurse naftëtarët dhe metalurgët për 1 lek kontribut marrin 1,6 lek përfitim. Pra, jemi duke folur për një kontribut të rëndësishëm nga buxheti i shtetit. Ajo që nuk kanë paguar ndër vite nëpërmjet kontributit, është drejtpërdrejtë kontribut i buxhetit të shtetit dhe tatimpagueseve për t'i trajtuar në të drejtë të tyre të merituar për shkak të vështirësisë së profesionit më mirë sesa pensionistët e tjerë.

Kështu, gjatë gjithë jetës minatorët kanë paguar mesatarisht 2 514 000 lekë kontribute dhe do të përfitojnë 8 556 000 lekë, kurse naftëtarët dhe metalurgët kanë paguar 3 162 000 lekë kontribute dhe do të përfitojnë 5 000 000 lekë. Mësuesit kanë paguar 5,08 dhe do të marrin 5,06.

Pra, duhet të kuptojmë si i trajton qeveria profesionet e vështira. Dua që të gjithë qytetarët të kuptojnë (komisioni është shumë i qartë) që shtesa paguhet nga buxheti i shtetit, nga tatimpaguesit. Kjo është ajo që ka bërë qeveria, Kryeministri dhe kjo maxhorancë për t'i trajtuar këto tre profesione të vështira ashtu siç e meritojnë.

Ky projektligj sanksionon, gjithashtu, edhe përkohshmërinë e këtyre përfitimeve. Kjo gjë nuk vazhdon pafundësisht, por në një afat të mëvonshëm pensioni suplementar shuhet. Kjo për faktin që sot këto industri janë private dhe duhet të gjejnë zgjidhje në fondet profesionale të përfshira në këtë ligj. Pra, ky ligj i detyron industritë të kalojnë në krijimin e fondeve profesionale në funksion të pagesave suplementare. Nuk ka detyrim shoqëria dhe shteti të privilegjojë daljen në pension herët apo të japë shtesë pensioni për personat që punojnë në kompani private, kurse ata që sot janë duke protestuar përfitojnë konsiderueshëm.

Është parashikuar që për këtë trajtim financiar shtesë, që financohet nga buxheti i shtetit pa paguar kontribute suplementare, do të përfitojnë pensionistët aktualë, punonjësit që punojnë aktualisht në këto industri dhe që sot kanë moshën 48 vjeç e sipër. Kjo për faktin se personat më të rinj se kjo moshë kanë mundësi që nëpërmjet sigurimit suplementar në skemat profesionale të vetëfinancojnë pensionin suplementar.

Është parashikuar pagimi i kontributeve shtesë për ata që punojnë dhe do të punojnë në këto industri në masën 5% pas daljes para kohe në pension, që është aktualisht për minatorët sipas parashikimeve të vendimit nr. 150\2014 plus 5% për të financuar shtesën mbi pension. Më konkretisht i kemi sipas neneve.

Unë do të bëj dy amendamente, që i konsideroj të rëndësishme. Për të cilat kemi rënë dakord me anëtarët e komisionit të maxhorancës, por sigurisht edhe pjesa e opozitës do të marrë pjesë në diskutim. Mbështetja ose jo është e drejta e tyre.

Do të përmend amendamentet dhe pastaj do t'i diskutojmë së bashku në ligj.

Janë disa minatorë, të cilët kanë qenë në trajtim të veçantë dhe kaluan në pension sipas ligjit nr. 150\2014, që kanë masë pensioni të ulët në nivelin e pensionit minimal rreth 16000 lekë. Ky pension është i ulët pasi punonjësit kanë dalë në pension me 23 vjet punë, nga të cilat 11,5 vjet punë në nëntokë. Pra, kanë një mungesë dhe trajtohen me paga minimale apo si fermerë. Masa e pensionit shtesë për këta del e ulët, sepse kanë 11,5 vjet dhe jo 12,5 vjet. Pra, humbasin trajtimin për një vit punë në nëntokë dhe kanë pensione të ulëta. Unë mendoj të

shtojmë një pikë ku të thuhet se përjashtohen nga kriteri i plotësimit të moshës 65 vjeç ata që përfitojnë pension sipas ligjit nr. 150\2014, por që nuk kanë plotësuar moshën 65 vjeç. Pra, janë rreth 1500 veta. Efekti financiar është i papërfillshëm, por drejtësia sociale është shumë e rëndësishme. Këta persona dora-dorës plotësojnë moshën 65 vjeç dhe nuk është barrë e rëndë financiare.

Së dyti (e falenderoj komisionin që ka rënë dakord me mua për këtë amendament), individëve që, për shkak të aksidentit në punë apo që janë me sëmundje profesionale, nuk kanë arritur të plotësojnë 12,5 vjet punë në miniera apo 20 vjet punë në naftë, unë mendoj t'u dhurohet automatikisht kjo vjetërsi, pavarësisht sesa kanë në realitet. Numri nuk është i konsiderueshëm, kurse drejtësia sociale është shumë e madhe. Jemi duke folur për individë që fatkeqësisht janë aksidentuar në punë e sipër, kanë fituar statusin e të aksidentuarit, por nuk përfitojnë pensionin. Pra, për shkak të një fatkeqësie, sëmundjeje apo aksidenti, u është privuar mundësia për të plotësuar vitet e punës. Unë kam kërkuar nga komisioni të bëjmë një amendament për ta përfshirë automatikisht në përfitim këtë grup duke i dhuruar vjetërsi pune.

Unë do ta mbyll prezantimin tim këtu. Ndërkohë, e hap mbledhjen për pyetje dhe opinione. Dua t'ju informoj se zoti Ismet ka bërë një amendament, që do ta prezantojë kur të diskutojmë nen për nen.

Kërkoj nga ju që të vazhdojmë me pyetje dhe opinione, në mënyrë që më pas të fillojmë me diskutimin nen për nen.

Faleminderit!

Po, zoti Ismet.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje!

Në fjalën e tij të gjatë kryetari i komisionit paraqiti relacionin e plotë. Informacioni dhe sqarimi ishte shterues. Jo vetëm për këtë komision, por për të gjithë ne, ky projektligj ka një rëndësi të madhe jo vetëm për dëgjesë, por edhe drejtësinë sociale dhe sidomos për trajtimin ekstra që i bëhet një fashe të caktuar të shoqërisë, e cila ka punuar në sektorë të vështirë, ku rrezikohet përditë jeta, siguria dhe shëndeti i tyre. Jo vetëm kaq, por këto tri kategori punonjësish, që kanë punuar në miniera në nëntokë, në sektorin e naftës dhe në metalurgji, jo vetëm i kanë dhënë benefite shumë të mëdha vendit dhe kontribut buxhetit të shtetit, por kanë lënë pas edhe pasuri, që janë produkt i mendjes dhe i kontributit të kësaj shtrese të shoqërisë sonë.

Në mënyrë të veçantë, unë evidentoj pasuritë natyrore të zbuluara, që janë ende në shfrytëzim dhe mbeten edhe për shumë vite e dekada të tjera jo vetëm në miniera, por sidomos në industrinë e naftës. E kam theksuar edhe dje, e theksoj edhe sot, që është mundi dhe

kontributi historik, gati 100-vjeçar, i punonjësve të kësaj industrie, që sot vendit i janë lënë rezerva gjeologjike të njohura, që shkojnë deri mbi 420 milionë tonë naftë.

Siç e përmenda edhe dje, shumë shoqëri të huaja kanë shprehur interes në fushën e kërkimit, zbulimit dhe zhvillimit të këtij sektori, që do të sjellë jo vetëm benefite ekonomike, por edhe zhvillime në të ardhmen. Ndaj, 13 300 minatorë, 7600 naftëtarë dhe 2500 metalurgë e meritojnë të trajtohen dhe ta marrin këtë bonus, që financohet nga buxheti i shtetit, në mënyrë të merituar, për shkak se ata kanë lënë pjesë nga jeta e tyre. Po t'u referohemi analizave dhe testeve të bëra në aspektin e gjendjes së tyre shëndetësore, por edhe të moshës mesatare, këto kategori punonjësish në vendin tonë janë poshtë mesatares në nivel kombëtar, këta e meritojnë plotësisht. Kështu që është bërë drejtësi sociale...

Arben Ahmetaj – Ndjesë, zoti Ismet, që ju ndërpres! Mund të vijojmë me pyetjen, pastaj me qëndrimet?

Ismet Beqiraj – Po, në parantezë.

Arben Ahmetaj – Paranteza ishte thujse një qëndrim.

Ismet Beqiraj – Po, qëndrim.

Arben Ahmetaj – Në fakt, ju i bëtë të dyja.

Ismet Beqiraj – Pra, edhe unë i mbështes tërësisht të gjitha ato, që ju miratuat për këtë çështje.

Arben Ahmetaj – Faleminderit! Mund të kaloni te pyetjet tani?

Ismet Beqiraj – Pyetja ime e parë ka të bëjë me faktin se në sektorin e industrisë së naftës dhe gazit ka dy kategori specialistësh të lartë, që quhen “personel inxhiniero-teknik” dhe “personel kërkimor-shkencor”, që kanë bërë, bëjnë dhe do të bëjnë në të ardhmen punë direkt në sektorë të rëndësishëm, si: kërkimi, nxjerrja dhe përpunimi i prodhimit (pra, edhe personeli inxhiniero-teknik, i cili ndjek, monitoron dhe drejton projektet e tyre). Në ligj kategoria e specialistëve inxhiniero-teknikë trajtohet, kurse fasha tjetër e specialistëve të kërkimit shkencor, që, për hir të së vërtetës, ka gati njëzetë vjet që institutet e naftës janë shkrirë dhe ata pothuajse janë specie në zhdukje, është e rrallë, por që, për hir të kontributeve që kanë dhënë, duhet të përfshihen në këtë skemë, ashtu sikurse përfshihet fasha e punonjësve të minierave, që, me të drejtë, nuk kanë mbushur vitet e punës, siç u shpreh edhe në amendament.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetja e dytë. Në germën “c” të nenit 2 të projektit, që është paraqitur, lidhur me emërtesën që thoni: “...në industrinë e naftës, në ndërmarrje, sektorë dhe brigada”, mos vallë bëjmë një ngurtësim ligjor, në një kohë kur organigrama historike (pra edhe më parë dhe tani) është shumë fleksible në këtë sektor, madje është fluide, ndryshon? Termat “brigadë” dhe

“sektorë” t’ua lëmë emërtesave të vendeve të punës dhe të profesioneve të vendimi i Këshillit të Ministrave, që do të dalë për këtë çështje. Për më tepër, nuk e shikoj të arsyeshme pjesën që hartuesit e projektligjit kanë futur vetëm një element të organigramës së një ndërmarrjeje. Për mendimin tim, është më e drejtë të lihet: “për sektorin e industrisë së naftës, në ndërmarrje, gjeofizikë”..., pra siç është aty dhe deri në fund. Nuk kam asnjë kontestim tjetër për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Kush do të përgjigjet?

Po, zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Lidhur me pyetjen e parë, siç e prezantuam edhe në relacion, kriteri i shpërblimit suplementar ka qenë vështirësia në punë. Thënë kjo, të dyja këto profesione, të cilat i përmendi deputeti, nuk klasifikohen si profesione të vështira ose shumë të vështira. Rrjedhimisht, këto dy profesione nuk janë përfshirë në skemën e shpërblimit suplementar.

Për pyetjen e dytë do të përgjigjet zoti Hado.

Astrit Hado – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen, referuar germës “c” të nenit 3, pse është kaluar në sektorë dhe në brigada, bëhet fjalë vetëm për personelin inxhiniero-teknik. Është menduar kështu, sepse ndërmarrjet e naftës kanë qenë edhe personel inxhiniero-teknik, që punonin në administratë ose në sektorë të tjerë, të cilët nuk janë të lidhur drejtpërsëdrejti me naftën. Domethënë, qëllimi i këtij projektligji është që këtë lloj shtese mbi pension, e subvencionuar nga buxheti i shtetit, ta përfitojnë vetëm ata persona, të cilët kryejnë një profesion të vështirë.

Për naftën është menduar ta përfitojnë vetëm ata persona, të cilët kanë punuar drejtpërsëdrejti në industrinë e naftës. Për shembull, tek Albpetrol-i ka edhe inxhinierë që punojnë në administratë, por që nuk kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti dhe për një kohë të vazhdueshme me naftën.

Kjo ka qenë arsyeja pse është kaluar në nivel sektori dhe brigade në prodhim vetëm për personelin inxhiniero-teknik.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Astrit!

Ka pyetje të tjera nga kolegët?

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar kolegë,

Përfaqësues të administratës,

E vlerësojmë këtë propozim dhe projektligjin për trajtimin financiar dhe suplementar të punonjësve të këtyre sektorëve.

Do të flas pak më konkretisht, pasi vij nga qyteti i Patosit dhe duhet t'i falënderoj të dy kolegët që i kam ballë për ballë, sepse e kanë ngritur disa herë këtë çështje.

Jam i shqetësuar për një problem, zoti kryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arsyeja është shumë e thjeshtë. Statusin e ka përfituar vetëm ky grup naftëtarësh, ndërkohë që tashmë, nëpërmjet këtij projektligji, trajtimi financiar bëhet së bashku për minatorët dhe metalurgët.

Absolutisht, jam dakord në parim dhe do ta votoj, madje i mbështes të dyja propozimet tuaja për amendamentet, dhe absolutisht ju vlerësoj, por kanë kaluar dy vjet e dy muaj nga periudha, kur ju keni votuar për statusin e naftëtarit dhe tashmë rreth 2300 naftëtarë i kanë marrë këto dëshmi. Ndaj, cili është përfitimi financiar për këta 2300 naftëtarë? A e kanë marrë këtë shpërblim financiar dhe pse është futur sot në këtë projektligj statusi i naftëtarit bashkë me dy profesionet e tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Cili do të përgjigjet nga administrata?

Elton Haxhi – Në parim, nëse këta 2300 naftëtarë plotësojnë kriteret që përcakton ky ligj, do ta marrin shpërblimin sipas këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, një sekondë!

Edhe një herë, zoti Haxhi, pra sqarimi juaj ishte që tani grupimi i përfitimit është në bazë të këtij ligji. Pra, duhet ta thoni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është me leje këtu!

Pra, praktikisht ky është ligji të cilit duhet t'i referohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, për shkak se formula krijonte disavantazhe ndërmjet profesioneve, qeveria ka menduar të ketë një grupim të profesioneve në një shportë të përfitimeve me financim suplementar dhe me parime të tjera. Ky është thelbi i qëndrimit të ligjit.

Keni ndonjë gjë tjetër, zoti Haxhi?

Po, Bashkim, ju lutem!

Bashkim Sala – Dua të bëj një sqarim lidhur me terminologjinë e statusit, që, në fakt, e bëra edhe dje. Në të kaluarën janë krijuar disa statuse, deri tek ai i naftëtarit, por më vonë është kërkuar edhe nga grupe të tjera për të pasur statuse. Kjo ministri mendoi për problematikën e shpërblimit të ulët të pensionit për tri kategoritë më të vështira.

Po marr një shembull lidhur me statusin, i cili është një kategori shumë më e gjerë sesa pensioni. Te statusi përfshihen kushtet e punës, ushqimi në punë, mjekësia në punë e me radhë, sipas kategorive. Këto industri sot janë private. Po marr shembull minierën e Bulqizës. Kontrata kolektive që ka punëdhënësi me Sindikatën e Minatorëve të Bulqizës plotëson gjithçka që përbën një status: mjekë, poliklinikë, kushtet e punës, trajtim shëndetësor dhe shpërblim mbi 12 paga në muaj. Të gjitha këto janë, në maksimumin e mundshëm, sipas rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Pra, statusi nuk është më një privilegj, por është një çështje ndërmjet punëdhënësit, punëmarrësit dhe kushteve që krijon ndërmarrja.

Arben Ahmetaj – E qartë.

Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, si thatë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka gjë. Përderisa keni interes, keni bërë mirë që keni ardhur.

Halil Jakimi – Duke marrë shkas që jam djali i një minatori dhe vij nga qyteti i Bulqizës, siç e përmendi edhe zotëria, minatorët, së pari, janë të diskriminuar, pasi nuk ka pagë referuese. Paga minimale, që deklarohet, është në vlerën 26 mijë lekë të rinj, që është miratuar në janar të vitit 2019.

Nuk është e vërtetë që minatorët e Bulqizës përfitojnë trajtim mjekësor falas dhe dy herë, përfshirë subjektin minerar, siç është “Balfin Group” dhe disa subjekte të rëndësishme.

Për sa i përket pjesës tjetër të subjekteve minerare më të vogla, mund të them se nuk i trajtojnë minatorët, ashtu siç edhe ata meritojnë.

Statusi zgjidh aksidentet në punë, por kur minatori humb jetën, bashkëshortes i sigurohet pension? Fëmijëve nën 18 vjeç u sigurohet pension?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, keni pyetje?

Halil Jakimi – Pyetje janë, sepse statusi... Domethënë, nuk e shoh me vend këtë projektligj që trajtimi suplementar të jetë vetëm për minatorët, që kanë dalë në pension. Po minatorët aktualë? Po problemet e tjera si zgjidhen?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, por...

Halil Jakimi – Vetëm statusi...

Arben Ahmetaj – ...ju jeni përfaqësues i opozitës nga Partia Demokratike?

Halil Jakimi – Po, nga Partia Demokratike.

Arben Ahmetaj – Unë jam i bindur që babai juaj do t'ju detyrojë të votoni për Partinë Socialiste, sepse, praktikisht, babai juaj do të përfitojë. Pra, edhe ata që kanë dalë në pension, edhe ata që janë aktualisht mbi moshën 45 vjeç do të përfitojnë drejtpërsëdrejti dhe minimalisht 20%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo do të thotë që, për herë të parë, nga koha e Meksit, e Nanos, e Berishës dhe e të tjerëve, kjo qeveri bën të mundur për minatorët dy përmirësime të rëndësishme në trajtimin e tyre financiar: uljen e moshës së pensionit të parakohshëm në 55 vjeç (të mos harrojmë se është minimalisht 10 vjet tani), pa ndryshimet në bazë të reformës së pensioneve nga sa dalin të tjerët, dhe, siç iu referuam, kontributin që është 1 lek, ndërsa përfitimi është 3,6 lekë (360% në raport me kontributin). Kjo është shumë e rëndësishme.

Unë jam i bindur që, nëse babai juaj, pastë jetën e gjatë, po dëgjon, herën e ardhshme do të të detyrojë të votosh për maxhorancën tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nejse, nuk do të të detyroj dot, se je...

Halil Jakimi – Po, mor, patjetër, do ta kthej.

Të flasësh nga kjo sallë, me të gjitha kushtet dhe komoditetin që keni, ju bën ju të ndieni privilegjin, por ju nuk i dini hallet dhe shqetësimet e minatorëve.

Ju shumë mirë që flisni, por unë nuk kam bërë kurrë politikë, sepse kam mbështetur protestat lokale të minatorëve dhe çdolloj proteste...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, bëni pyetjen!

Halil Jakimi – Ju lutem!

Arben Ahmetaj – Pastaj mbani qëndrimin.

Halil Jakimi – Ju lutem, mos kaloni në aspekte...

Arben Ahmetaj – Më falni, por bëni pyetjen!

Halil Jakimi – ...që nuk kanë të bëjnë me...

Arben Ahmetaj – Nuk kaloj asgjëkundi, ju bëni pyetjen!

Halil Jakimi – Pyetja?! Vetëm statusi do ta zgjidhte këtë. Minatorët nuk janë... Nuk e shoh me vend që...

Arben Ahmetaj – Kjo nuk është pyetje, por ky është qëndrim.

Halil Jakimi – Është një lëmoshë.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Halil Jakimi – Për mendimin tim, është një shpërblim lëmoshë.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Halil Jakimi – Që një pensionist përfiton 26 mijë lekë të rinj sot, nesër pensioni që i lidhet kur të dalë në pension, do të jetë 200 mijë lekë. Çfarë shpërblimi është ky?! Nuk zgjidh asgjë!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Gjithsesi, besoj se gjatë diskutimit nen për nen edhe ju do të sqaroheni për përfitimet.

Ka pyetje të tjera? Po, ju lutem.

Nimet Musai – Faleminderit!

Kam edhe një pyetje tjetër. Megjithëse statusin e kanë përfituar këta 2300 naftëtarë, një pjesë tjetër, siç e thatë edhe ju në fjalën tuaj, nuk janë përfshirë për arsye të ndryshme, si vështirësia e punës dhe problemet e ndryshme që kanë ndodhur.

Lidhur me përjashtimin nga përfitimi i statusit të naftëtarit të punonjësve të Repartit Elektrik dhe Telefonisë, që ka qenë dhe është në shërbim të prodhimit të naftës, për të mos ju humbur kohë, kam disa nene të veçanta, që nga viti '58 e në vazhdim, që do t'i them...

Arben Ahmetaj – Më falni që ju ndërpres, por këto do t'i shohim kur t'i diskutojmë nen për nen!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qëndrimet tuaja do t'i bëni kur të diskutojmë nen për nen.

Nimet Musai – Faleminderit, zoti kryetar!

Arben Ahmetaj – Nuk ka problem, por si procedurë...

Nimet Musai – Më duhet të shkoj te një komision tjetër, prandaj mendova t'i përmendja tani.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Lërimi me shkrim, nëse mundeni, në mënyrë që ne t'u referohemi kur t'i kalojmë nenet ose, nëse dëshironi, adresojeni njërin nga kolegët që, gjatë diskutimit nen për nen, të ketë mundësi t'i shprehë qëndrimet tuaja. Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit juve!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi— Siç e theksova edhe më parë, kriteri i përfitimit të shpërblimit suplementar është vështirësia në punë dhe jo kontributi. Pra, kontribut mund të kenë dhënë një sërë departamentesh ose një sërë profesioneve të lidhura me shfrytëzimin e burimeve natyrore, të cilat nuk kanë pasur të njëjtën vështirësi pune.

Kriteri që ne zbatojmë në hartimin e këtij projektligji, është thjesht vështirësia në punë në sektorët e përcaktuar në ligj, ndërsa profesionet e tjera, siç i përmendi deputeti tjetër, si personeli inxhiniero-teknik, që nuk ka punuar në terren apo personeli kërkimor-shkencor, nuk kanë të njëjtën shkallë vështirësie, për rrjedhojë nuk janë trajtuar në këtë projektligj.

Pra, të mos e ngatërrojmë kontributin, se kontribut mund të ketë dhënë administratori i shoqërisë apo edhe financieri i kësaj të fundit, nuk mund t'ua mohojmë kontributet, por shkalla e vështirësisë së këtyre profesioneve nuk është e vështirë ose shumë e vështirë.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin Bushati - A mund të shtosh...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Prisni, të vijë kryetari!

Arben Ahmetaj – U përgjigjet, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elton Haxhi – Zoti Hado ka diçka për të shtuar.

Arben Ahmetaj – Po, ju lutem, zoti Hado!

Astrit Hado – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vazhdim të shpjegimit që dha zëvendësministri, për sa i përket repartit të telefonisë dhe elektricitetit në ndërmarrjet e naftës, se nuk është marrë industria për të dhënë përfitim, por profesioni, ne jemi përpjekur që të ruajmë dhe të kemi një trajtim të barabartë për të gjithë punonjësit që kanë punuar në atë kohë dhe punojnë aktualisht në ndërmarrje. Sepse një tornitor ose një elektriciist, që ka punuar në naftë, nuk ka një punë më të vështirë se sa një tornitor, apo një elektriciist që ka punuar në Uzinën e Auto-Traktorit...

Arben Ahmetaj – Është e qartë.

Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera, ka ndonjë qëndrim?

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë nuk kam pyetje, sepse projektligji diskutohet dhe konsultohet prej kohësh. Kështu që ne tashmë i kemi sqaruar shumë pikëpyetje ose detaje që lidhen me të.

Por, së pari, dua të them që ky projektligj është një arritje e rëndësishme për t'iu përgjigjur kërkesave të drejta të këtyre tri kategorive prej vitesh e vitesh me radhë, pavarësisht se me vonesë. Madje, mendoj se ne u detyrohemi një ndjesë të madhe të tria kategorive: edhe minatorëve, edhe metalurgëve, edhe naftëtarëve, për shkak të vonesës, pasi kjo gjë duhet të ishte bërë kohë më parë.

Së dyti, e vlerësoj këtë projektligj, pas më në fund kemi një projektligj që është i zbatueshëm dhe i përballueshëm për buxhetin e shtetit, sepse, në fakt, ne mund të kishim dashur të bënim shumë më tepër dhe ata vërtet meritojnë shumë më tepër, por është e rëndësishme që ne të hartojmë një projektligj që e përballon buxheti i shtetit sot dhe nesër, sepse nuk mund të marrim përsipër gjëra, që t'ua lëmë pastaj mbi shpatulla fëmijëve tanë, apo brezave që do të vijjnë. Kjo është arritja më e madhe, që ky ligj është i zbatueshëm dhe i përballueshëm për buxhetin e shtetit, pra më së fundi, do të bëhet realitet.

Së treti, e vlerësoj që ky projektligj i integron të tria këto profesione, sepse gjatë muajve të fundit është folur shumë për profesionin dhe për statusin e naftëtarit dhe sikur janë lënë pak në harresë minatorët dhe metalurgët, të cilët janë gjithashtu, profesione shumë të vështira dhe meritojnë të trajtohen me trajtim të veçantë financiar. Unë jetoj në një qytet metalurgësh dhe i kam parë nga afër vuajtjet dhe sakrificat e tyre. Një pjesë e madhe e tyre ndërrojnë jetë që në moshë të re, për shkak të sëmundjeve profesionale apo për shkak të aksidenteve në punë. Ata nuk arrijnë t'i gëzojnë përfitimet, që u sjell projektligji.

Kështu, i falënderoj shumë të gjithë ata, që kanë marrë pjesë në hartimin e këtij projektligji. Në fund të fundit, është një premtim i mbajtur dhe unë i falënderoj të gjithë, edhe kryetarin e komisionit, i cili ka dhënë një kontribut të madh për hartimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Ka ndonjë qëndrim tjetër?

Blerina Gjylameti - Faleminderit, kryetar!

Realisht, edhe unë ndihem shumë mirë që më në fund, mbas kaq shumë vitesh arritëm të kemi një projektligj, i cili u jep realisht përgjigje shumë shqetësimeve jo vetëm për naftëtarët, jo vetëm për metalurgët, por edhe për minatorët në mënyrë të posaçme. Mendoj se jo vetëm mënyra se si është hartuar, jo vetëm që e bën të zbatueshëm në realitet, por nga ana tjetër, ajo që është më e rëndësishme dhe që ka qenë në thelbin e vizionit të kësaj maxhorance, është

fakti që ne nuk mund t'u lëmë një barrë një financiare brezave të ardhshëm më të madhe nga sa mund të paguajnë.

Nga ana tjetër, duke marrë parasysh edhe skemën e pensioneve, por edhe normën e rritjes së popullsisë, shoh se ky është një projektligj, i cili nuk e cenon stabilitetin e të gjithë skemës së pensioneve.

Po ashtu, duke u përgjigjur problematikave që ngrenë këto kategori, shqetësimi tjetër që gjen zgjidhje këtu dhe këtu unë dua të falënderoj kryetarin e komisionit, zotin Ahmetaj, se fillimisht, kur kemi diskutuar për statusin e naftëtarit, ka qenë pak më i tërhequr, siç mund të jetë çdokush që është në postin e ministrit të Financave, që ka si objektiv kryesor stabilitetin financiar, po ashtu dhe shëndetshmërinë e skemave. Më pas, duke diskutuar me ekspertët e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe me të gjithë ekspertët e fushave që mbulojnë këto 3 kategori, kemi ardhur sot në një moment, kur jo vetëm s'kemi ndonjë shqetësim, por po gjejmë zgjidhje për shqetësimet e tyre.

Nga ana tjetër kryetar, unë kam një vëmendje të shtuar dhe do të doja ta kishim si komision ndaj Inspektoratit të Punës, ndaj hetimit tatimor dhe ndaj Drejtorisë së Tatimeve në mënyrë të posaçme, që ato shqetësime që po ngremë këtu sot, kur themi se tatimet minimale të pagës së minatorëve, të naftëtarëve dhe të metalurgëve, nuk janë shqetësime që gjejnë zgjidhje duke ndryshuar ligjin për pensionet suplementare apo atij për pensionet, por është një shqetësim që gjen zgjidhje duke pasur një rol më të fortë monitorues të këtyre inspektorateve apo të këtyre institucioneve për të parë në të gjitha bizneset private që operojnë në këta 3 sektorë, nëse i zbatojnë së pari pjesën e rregullave të sigurisë në punë, pjesën e pagës minimale dhe të informalitetit që ka ndërmjet pagës që deklarojnë dhe asaj që marrin realisht dhe së treti, pjesën e investimeve sipas kontratave që kanë për të pasur kushte më të mira pune dhe pagesa më të mira për të tria profesionet.

Sot që flasim, këta 3 sektorë janë kryesisht privatë, shumë pak janë publikë dhe ajo që gjen zgjidhje nëpërmjet këtij projektligji, është pikërisht forcimi i punës sonë monitoruese si komision drejt këtyre institucioneve në mënyrë që ato të bëjnë punën e duhur dhe ato shqetësime që kanë minatorët, metalurgët apo edhe naftëtarët, të gjejnë zgjidhje nëpërmjet forcimit të rolit të këtyre institucioneve dhe jo nëpërmjet ndryshimit të ligjit.

Faleminderit shumë!

U kërkoj kolegëve ta mbështesin këtë projektligj, sepse besoj se u jep zgjidhje problemeve që kanë vite të shumë personave. Ky është një premtim, të cilin ne e kemi marrë prej disa vitesh dhe sot po e bëjmë realitet.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Gjylameti!

Është shumë i saktë dhe i rëndësishëm observimi juaj në lidhje me Inspektoratin e Punës. Besoj se në vazhdimësi ne do të kërkojmë një raportim të vazhdueshëm të Inspektoratit të Punës, nëpërmjet Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ismet, cili është qëndrimi juaj, që padyshim, është i rëndësishëm, por duhet të jetë i kufizuar në kohë, sepse ju keni mbajtur dy qëndrime rresht (kuptohet në të njëjtën logjikë), por koha është e kufizuar se do ta shqyrtojmë edhe nen për nen.

Ismet Beqiraj - Faleminderit, kryetar!

Besoj se unë e kam rezervuar kohën time gjatë aktiviteteve në Kuvend, sidomos në sallën e Kuvendit dhe unë ia vë në dispozicion këtij momenti të rëndësishëm. Unë e mbajta qëndrimin për të tri kategoritë: minatorët, naftëtarët dhe metalurgët, por si një ish-naftëtar që e kam filluar punën në këtë sektor të rëndësishëm dhe të vështirë, e ndjej rolin dhe vështirësinë. Unë e kam në lëkurën time jo vetëm profesionin, por të gjithë sakrificën që kanë bërë këta njerëz, kjo armatë e madhe që i ka dhënë jo vetëm jetë kësaj industrie, por edhe benefite të mëdha.

Sot diskutimi i këtij projektligji është i qartë. U tha se drafti nuk është një status. Statusi i naftëtarit, i miratuar në vitin 2017, që shpreh vullnetin e mirë të kësaj qeverie, të kësaj maxhorance, është në fuqi, por miratimi i këtij ligji e bën efektiv këtë status në benefitet e tij. Statusi ka shumë benefite jo vetëm për uljen e moshës, apo përfitimin e viteve të punës për të dalë para kohe në pension nga ligjet në fuqi të sigurimeve shoqërore në vendin tonë, por ata përfitojnë deri në 10 vjet. Sot...

Arben Ahmetaj – Më falni Ismet, cili është konkluzioni i qëndrimit?

Ju lutem!

Ismet Beqiraj - Po.

Ky është benefiti i parë, që e bën efektiv këtë pjesë të statusit, përveç benefitit financiar.

Nga ana tjetër, unë e theksoj edhe një herë, se punonjësit që i plotësojnë kriteret që marrin statusin e naftëtarit 6 vjet e lart për çdo vit pune sipas koeficientit të vlerësimit, e përfitojnë. Deri tani nuk e kishin as këtë status.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe statusi që është në fuqi është një risi dhe sjell një përmirësim serioz. Pra, ky është një benefit tjetër plus, që e marrin të gjithë punonjësit, që kanë më shumë se 6 vjet në punë. Ta kemi të qartë këtë.

Arben Ahmetaj – Do t'ju lutesha të jepni konkluzionet, se do të fillojmë shqyrtimin nën për nen!

Ismet Beqiraj - Pas sugjerimit që bëri kolegja Gjylameti për Inspektoratin e Punës, edhe unë u kërkoj sot Inspektoratit të Punës dhe strukturave të tjera shtetërore të kontrollojnë kompanitë edhe pse ato janë private, aksionere, apo publike në aspektin e riskut dhe të sigurisë në punë, për plotësimin e kushteve të punës dhe të kontratave kolektive. Ka ende kompani, që nuk i kanë lidhur kontratat kolektive me këta punonjës dhe që kanë një sërë problemesh edhe në aspektin e kontrollit shëndetësor si detyrim i statusit.

Nga ana tjetër, u bëj apel dy ministrive përkatëse që VKM-të e mbetura akoma nga implementimi i plotë i statusit të naftëtarit (janë 5 VKM që do të dalin për të rregulluar zbatimin praktik të këtij ligji...

Janë, 5 jo 7.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse janë shtuar, aq më mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse janë 7 aq më mirë. Të dalin në afatet optimale kohore që parashikohen në ligj dhe jo të zvarriten 1-2 vjet dhe në disa raste, të mos dalin fare.

Arben Ahmetaj – Faleminderit për sugjerimet dhe për ato që theksuat!

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima - Faleminderit, kryetar për kontributin dhe për mbështetjen që keni dhënë për hartimin e këtij projektligji!

Njëkohësisht, falënderoj edhe përfaqësuesit e ministrisë dhe ata të Sigurimeve Shoqërore, të cilët kanë dhënë kontribut për hartimin e këtij projektligji. Qeveria shqiptare dhe Kryeministri Rama e kanë konsideruar si shumë të rëndësishme kategorinë e naftëtarëve, të minatorëve dhe të metalurgëve që punojnë në 3 sektorë shumë të rëndësishëm, të cilët kanë ndikuar në ekonominë kombëtare kanë dhënë kontributin e tyre për krijimin e të ardhurave.

Punonjësit që kanë punuar në këta sektorë, janë përballur me shumë vështirësi dhe me problematika të shtuara edhe për shëndetin e tyre e në disa raste, kanë humbur edhe jetën. Me këtë projektligj ne mundësojmë që kategoria e naftëtarëve, minatorëve dhe e metalurgëve, të vlerësohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ju lutem, mbani qetësi ta dëgjojmë, zonjën, sepse ajo vjen nga një rajon ku ka shumë naftëtarë!

Antoneta Dhima – Ata po presin që ky projektligj të zbatohet sa më shpejt, sepse 2300 naftëtarë kanë marrë dëshmitë nga ministria dhe po presin që të përfitojnë pagesën e punës që ata kanë kryer në vite.

Ajo që desha të sqaroj dhe të orientoj për t'u ndjekur nga ana e ministrive përgjegjëse është pagesa e kontributit nga ana e kompanive, të cilat nuk kanë filluar ta bëjnë pagesën sipas ligjit për statusin e naftëtarëve. Nuk e di, por sipas informacionit që kam ende nuk ka filluar të bëhet pagesa e 3-përqindëshit, gjë që sipas ligjit duhej të kishte filluar. Kjo është një detyrë që duhet të ndiqet, përveç propozimeve që kolegja Gjylameti bëri për Inspektoratin e Punës, për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për institucionet e tjera, që janë përgjegjëse për zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore në zbatim të statusit të naftëtarëve.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është pro?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nën për nën të projektligjit.

Më falni! Para se ta kalojmë nën për nën, po lexoj raportin e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Unë po lexoj vetëm komentet që janë bërë nga ky komision.

“Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me nenet 78, 83, pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Ai bazohet në nenet 78, 83 pika 1, të Kushtetutës.

Projektligji “Për trajtimin financiar, suplementar, të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, ka për qëllim të japë një kontribut, në kuadër të rolit social të shtetit, duke mundësuar një trajtim financiar më të plotë dhe mbulimin me përfitime, përpara kohës së mbushjes së moshës për pension, si dhe përfitimet shtesë, mbi ato që akordohen nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

Po kaloj te ndryshimet. Neni 1, riformulohet me këtë përmbajtje:

“Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar, i punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve, që kanë punuar në metalurgji, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet

shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë” të ndryshuar”” dhe me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Qartë. Unë po i lexoj gjithsesi.

“Në nenin 2 bëhen këto ndryshime: paragrafi i parë riformulohet me këtë përmbajtje:

“Përfitues, sipas këtij ligji, janë personat në profesione e punë në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës e të gazit dhe në metalurgji, që u njihet vjetërsia në punë dhe periudha e sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji e që njëkohësisht, plotësojnë edhe kushtet e tjera të përcaktuara në këtë ligj, si më poshtë vijon: “Në shkronjën “a”, pas përcaktimit “ në Republikën Popullore të Shqipërisë” shtohet përcaktimi “të ndryshuar”, si dhe pas përcaktimit “dhe” shtohet përcaktimi “ligjit”. Besoj se kjo është teknikë ligjore.

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë po i lexoj një herë propozimet e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë për nenet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

- Përpara çdo paragrafi vendosen numra (gjithsej 6 pika);
- Pikat 3 dhe 4, riformulohen me përmbajtjen e mëposhtme: “3. Për efekt përfitimi sipas këtij ligji, proceset e punës në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës dhe në metalurgji, pas datës 30.9.1993, do të njihen, nëse janë kryer dhe dokumentuar sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar””.

“4. Emërtimet e profesioneve dhe punëve si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958, të Këshillit të Ministrave, “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar””, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”

- Në pikën 5, përcaktimi “në pikën 3” zëvendësohet me përcaktimin “në nenin 3” dhe referenca ligjore “sipas nenit 6” zëvendësohet me referencën “sipas nenit 8”.

Në fund të pikës 6, përcaktimi “për këtë ligj” zëvendësohet me përcaktimin: “për qëllime të këtij ligji””.

Besoj se ju i keni parë këto. Çfarë qëndrimi keni mbajtur?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

“Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:

- Paragrafi i parë riformulohet me këtë përmbajtje: “Personat e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, kanë të drejtën e përfitimeve të pensionit për shkak të profesionit apo të shtesës mbi pension, kur plotësojnë kushtet, si më poshtë vijon:”

- Në pikën 1, shkronja “c”, paragrafi i fundit riformulohet me këtë përmbajtje: “Kur nuk plotësohen kushtet sipas shkronjës “b” të këtij neni, periudha e punës sipas shkronjës “b” i shtohet periudhës së punës sipas përcaktimeve në shkronjën “c” të këtij neni. Në këtë rast, kushtet e përfitimit janë ato sipas shkronjës “c”, nënpika “i” deri “iii”.”

Besoj se instituti i ka parë këto, Astrit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

“Në nenin 6 bëhen këto ndryshime:

- Titulli i nenit 6 të riformulohet: “Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë dhe të shtesës për pension invaliditeti”.

- Në pikën 1, termi “Masa e përfitimit”, të zëvendësohet me termin “Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë”,

- Në shkronjën “a” të pikës 1, termi “ish-punonjës”, të zëvendësohet me termin “punonjësit” dhe pas përcaktimit “të cilët kanë përfituar”, të shtohet përcaktimi “pension pleqërie”.

- Në pikën 2 përcaktimi “Masa e përfitimit për invalidët” të zëvendësohet me përcaktimin: “Masa e përfitimit të shtesës për pension invaliditeti”.

Gjithashtu, për unifikim termash, termi “Përfituesit” të zëvendësohet me termin “Punonjësit”. Pas përcaktimit “të cilët kanë përfituar”, të shtohet përcaktimi: “pension pleqërie” dhe përcaktimi: “kanë të drejtën e përfitimit të shtesës”, të zëvendësohet me përcaktimin “përfitojnë shtesë”.

Besoj Astrit, duhet ta shikoni këtë, së bashku me sekretarinë e komisionit, sepse mund të zgjerohet kategoria. Kështu që duhet ta shohim mirë përpara se të mbajmë qëndrim.

Atëherë, vazhdojmë me nenin 1. Unë kam një qëndrim, duke iu referuar edhe punës që ka bërë sekretaria e komisionit, për qëllime të teknikës legjislative, neni 1 i projektligjit riformulohet me këtë përmbajtje: “Qëllimi i këtij ligji është trajtimi financiar i punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit dhe punonjësve që kanë punuar në metalurgji, përveç trajtimit të përcaktuar në ligjin nr. 4171 të vitit 1966 “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë

11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, i përputhur me atë rekomandim. Kush është dakord me nenin 1? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 2. Në nenin 2, sugjerohet të bëhen këto ndryshime: paragrafi i parë, për saktësi dhe teknikë legjislative, formulohet me këtë përmbajtje “Përfitues, sipas këtij ligji, janë personat në profesione e punë në miniera në nëntokë, në industrinë e naftës dhe të gazit dhe në metalurgji, të cilëve u njihet vjetërsia e punës dhe periudha e sigurimit sipas përcaktimeve të nenit 3 të këtij ligji, që njëkohësisht plotësojnë edhe kushtet e tjera të përcaktuara në këtë ligj si më poshtë vijon”:

Në germën “a” saktësohen titujt e ligjeve, të cilat referohen.

(Mungesë dëgjimi)

Ju kërkoj ndjesë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e rëndësishme, sepse “në minierë, në nëntokë...” dhe vazhdon historia e zgjerimit të kategorisë pa fund.

Atëherë në nenin 3 bëhen këto ndryshime:

Vendosen numra para paragrafëve.

Ismet Beqiraj – Në nenin 2 unë propozoj që në germën “ç” pas shprehjes “industria e naftës dhe gazit” të shtohet “personeli inxhiniero-teknik dhe kërkimor shkencor”.

Po në këtë nen unë mendoj që në germën “d” të bëhet ky ndryshim: pas shifrës romake XII të hiqet togfjalëshi “të vendimit” dhe të shtohet “të pasqyrës numër një në vendimin...”, sepse kjo teknikë është përdorur edhe më poshtë.

Amendimi tjetër për nenin 2 është që në fund të fjalisë të shtohet fjala “të ndryshuar”. Kjo ka të bëjë me vendimin nr. 526 të vitit 1958, sepse diku citohet “të ndryshuar”, ndërsa këtu jo. Unë propozoj që edhe në nenet e tjera të shtohet fjala “të ndryshuar”, sepse nga viti 1958 deri në vitin 1993 është ndryshuar 48 herë. Këto ishin propozimet e mia për këtë nen.

Arben Ahmetaj –Çfarë mendimi ka ministria për këtë pikë?

Elton Haxhi- Në lidhje me çështjen e parë e shprehëm qëndrimin tonë gjatë diskutimeve dhe nuk jemi dakord.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Unë mendoj që te propozimi i zotit Ismet, për vendimin nr. 526 të vitit 1958, të shtohet fjala “të ndryshuar”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, referencë pasqyre nuk fusim në ligj.

Po, zoti Astrit.

Astrit Hado – Do të mbahet i njëjti qëndrim, sipas kreut, për të gjithë.

Arben Ahmetaj- Atëherë, me konfirmimin që bëmë për ndryshimin e fundit, të cilin e propozoi zoti Ismet, dua që sekretaria ta regjistrojë. Kush është dakord me propozimin e zotit Ismet, që kategoria të zgjerohet? Kundër? Abstenim?

Propozimi i zotit Ismet bie, përveç vendimit nr. 526 të vitit 1958.

Faleminderit, zoti Ismet!

Dua të konfirmoj para komisionit dhe publikut qëndrimin tuaj të vazhdueshëm së bashku me zonjën Dhima dhe zotin Xhevit, si tre përfaqësues nga një zonë me shumë naftëtarë, ju falënderoj për kontributin e vazhdueshëm dhe mbështetjen që i keni dhënë komisionit, mua dhe qeverisë për të hartuar këtë ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër, sepse nuk kemi mbaruar, por doja të flisja për këtë nen, që është shumë i rëndësishëm.

Në nenin 3 vendosen numra para çdo paragrafi. Paragrafi 3, për teknikë legjislativë, ndahet në dy paragrafë që numërtohen pika 3 dhe pika 4 dhe riformulohen me përmbajtjen e mëposhtme:

Pika 3 “Për efekt përfitimi, sipas këtij ligji, proceset e punës në miniera në nëntokë (bie presja, sepse riskon zgjerimin e kategorisë) në industrinë e naftës dhe në metalurgji, (në çdo rast hiqet presja, sepse sjellë keqinterpretim) pas datës 30.09.1993 do të njihen nëse janë kryer dhe dokumentuar sipas kriterëve të përcaktuara në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958 të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, pavarësisht nëse të punësuarit kanë kryer aktivitet ekonomik në subjekte me kapital plotësisht ose pjesërisht shtetëror, si dhe në subjekte private”. Pra, ky është diskutimi në parim që kemi bërë në vazhdimësi. Megjithatë, dua të di se cili është qëndrimi juaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, të konfirmohen fjalët e sakta, sepse si parim biem dakord.

Pika 4. Emërtimet e profesioneve dhe punëve, si pasojë e ndryshimeve të teknologjisë, organizimit e të pronësisë së kapitaleve, të cilat nuk përputhen apo parashikohen në vendimin nr. 526, datë 20.12.1958 të Këshillit të Ministrave “Për ndarjen e punëve në kategori, për efekt pensioni”, të ndryshuar, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.” Paragrafi 4 bëhet pika 5 dhe përcaktimi në pikën 3 zëvendësohet përcaktimi në nenin 3 dhe referencat ligjore sipas nenit 6 zëvendësohen me referenca ligjore sipas nenit 8, që shkojnë me ndryshimet.

Paragrafi i fundit bëhet pika 6 dhe fjalët “Përcaktimi për këtë ligj” zëvendësohet me “Përcaktimi për qëllime të këtij ligji”. Çfarë qëndrimi kanë përfaqësuesit e ministrisë për këtë?

Bashkim Salo –Jemi dakord me ndryshimin.

Arben Ahmetaj- Zoti Ismet, keni ndonjë problem me këto ndryshime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 4. A ka ndonjë koment ose propozim për ndryshim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E korrektuam.

Kush është dakord me propozimet e lexuara dhe të votuara? Kundër? Abstenim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni kundër të gjithë nenit 3?! Kujdes, sepse qëndrimi juaj politik ka qenë pro nenit 3 vazhdimisht.

Atëherë, miratohet neni 3 me ndryshimet që lexuam dhe konfirmuam së bashku me ministrinë.

Neni 4. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 4.

Neni 5. Në nenin 5 bëhen këto ndryshime: në pikën 1 germa “c” paragrafi i fundit riformulohet për saktësim të dispozitave referuese në këtë ndërmarrje: “Kur nuk plotësohen kushtet, sipas germës “b” të këtij neni, periudha e punës sipas germës “b” i shtohet periudhës së punës sipas përcaktimeve në shkronjën “c”. Në këtë rast, kushtet e përfitimit janë po ato sipas shkronjës “c” të këtij neni”

Astrit, kam një koment dhe një vërejtje. Të dy amendamentet që unë propozova, sidomos për pjesën e invalidëve, kur të vijmë te nenet përkatëse, dua të më ndihmoni t’i parashtrojmë. Dakord?

Faleminderit!

Astrit, mos duhet të jenë të parashikuara në nenin 5?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni menduar që të dyja amendamentet e mia t’i parashikoni në nenin 6?

Astrit Hado- Po.

Arben Ahmetaj –Dakord. E rëndësishme është që të jenë dhe të zgjidhin problemet.

A keni ndonjë problem me komentin dhe ndryshimin që kemi propozuar si komision? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ismet, keni ndonjë propozim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse rrëzohet, nuk përsëritet.

Kush është dakord me ndryshimin që unë propozova në bazë të logjikës së sekretariatit? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë te neni 6 “Masa e përfitimit të shtesës mbi pension” ka dy ndryshime, që unë kam propozuar të formatohen në atë mënyrë që t’i votojmë tani.

Sugjerimet e mia janë: titulli i nenit 6, për qëllime saktësimi, riformulohet: “Masa e përfitimit të shtesës për pensionin e pleqërisë dhe shtesës për pensionin e invaliditeti”. A jeni dakord? Dakord.

Në pikën 1 përcaktimi “Masa e përfitimit për plotësim” unë sugjeroj të zëvendësohet me përcaktimin “Masa e përfitimit të shtesës mbi pensionin e pleqërisë”. A jeni dakord? Dakord.

Në germën “a” të pikës 1, termi “ish-punonjës” të zëvendësohet me termin “punonjësit” dhe pas përcaktimit “të cilët kanë përfituar” sugjeroj të shtohet përcaktimi “pension pleqërie”. A jeni dakord?

Astrit Hado- Ne mendojmë që termi “ish-punonjës” është përdoruar për faktin se ata kanë qenë ish-punonjës, ndërsa tani ata kanë statusin e pensionistit.

Arben Ahmetaj – Është shumë e saktë, sepse ata tani janë pensionistë. Kështu që rrëzohet propozimi për ndryshim termash.

Astriti ka të drejtë, sepse terminologjia është e konsoliduar në ligj. Në pikën 2, përcaktimi “masa e përfitimit për invalidët” unë sugjeroj të zëvendësohet me përcaktimin “masa e përfitimit të shtesës për pension invaliditeti”. Gjithashtu, për unifikim termash sugjeroj që termi “përfitues” të zëvendësohet me termin “punonjësit” dhe pas përcaktimit “të cilët kanë përfituar” sugjeroj të shtohet përcaktimi “pension pleqërie”.

Astrit Hado – Unë mendoj të lihet siç është, sepse është e lidhur me pikën e parë.

Arben Ahmetaj - Lidhur me përcaktimin “masën e përfitimit për invalidët”, nuk duhet t’i referohemi termit “invalidët”, por “masa e përfitimit të shtesës për pensione invaliditeti”.

Po, Bashkim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal, po të lexoni ligjin, është “masa e përfitimit për invalidët” dhe ajo që po sugjeroj unë është që të thuhet “masa e përfitimit të shtesës për pensionet e invaliditetit”. Ligji, në trungun e vet, ka këto tri profesione.

Bashkim Salo – Meqenëse jemi te neni 6, ne mendojmë që propozimi për amendimin tuaj të dytë, i cili ka të bëjë me përjashtimin nga rritja e moshës 65 vjeç për trajtimin e veçantë të ish-minatorëve, që kanë dalë në pension me ligjin nr. 150, të vendoset si germa “c” te pika 1.

Arben Ahmetaj – Pra, propozimi im i parë për ndryshim...

Bashkim Salo – ...është që te pika 1 të shtojmë një germë “c” dhe formulimin...

Arben Ahmetaj – Jemi duke folur për pjesën e invalidëve në aksidente në punë dhe sëmundjet profesionale?

Bashkim Salo - Jo, po flasim për minatorët, të cilët kanë dalë me ligjin nr.150.

Arben Ahmetaj – Të dyja?

Bashkim Salo – Këtë do ta bëjmë këtu, ndërsa atë të aksidenteve në punë do ta vëmë te pika 2 e këtij neni.

Arben Ahmetaj – Unë jam dakord, por duhet lexuar qartë dhe të votohet qartë.

Bashkim Salo – Po.

Arben Ahmetaj – Astrit, lexojeni përkufizimin ju lutem!

Astrit Hado – Germa “c” te pika 1, shtesën për pension, sipas germës “a” të këtij neni, e përfitojnë edhe personat që marrin pension sipas ligjit nr.150/2014 të datës 31.12.2014.

Arben Ahmetaj- Për shkak të procedurës, kjo të formatohet në emrin tim dhe të votohet në tërësinë e nenit.

Bashkim Salo – Për invalidët është e dyta dhe në fund të saj shënohet, sipas përcaktimit të nenit 3 të këtij ligji, “jo më pak se 12 vjet e 6 muaj për minatorët dhe 20 vjet për naftëtarët dhe metalurgët.”

Arben Ahmetaj – A jeni dakord?

Person – Duhet të shtohen fjalët “për invalidët nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale”...

Arben Ahmetaj – Duhet shtuar “aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale”, sepse janë kategori specifike.

Bashkim Salo – Sepse këtyre po ua bëjmë nderin.

Arben Ahmetaj – Propozimi im nuk ka të bëjë me nderin, por ka të bëjë me drejtësi sociale. Faleminderit që na ndihmuat për formatimin e teknikës ligjore!

Dua t’i kërkoj ministrisë, zoti Haxhi, sidomos zotit Hado, zotit Kuka dhe Bashkimit, që në fund, të ndjekin formulimet përfundimtare që të jemi korrektë me ato që kemi vendosur si parime. A jeni dakord? Në rregull.

Sekretaria, bashkë me ju, të konfirmojë gjuhën përfundimtare të ligjit.

Neni 6. Kush është dakord me ndryshimet që u referuan dhe pranuam? Kundër? Abstenim?

Miratohet. Jam shumë i lumtur!

Neni 7.

A ka ndonjë gjë për nenin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të bëni ndonjë koment apo ndryshim?

Roland Xhelilaj – Dua të bëj një koment te e drejta e ndryshimit. Nuk e di nëse jam i saktë apo jo, duke pasur parasysh se ky është një projektligj shumë i rëndësishëm, i cili mbështet në 3 kolona të përfuturit suplementar për 3 profesione të vështira.

Shtesa mbi pensionet e pleqërisë është shumë e rëndësishme, sepse prek një kategori shumë të madhe minatorësh, të cilët, pas mbylljes së minierave dhe zvogëlimit të këtij sektori, kanë mbetur në vend. Pensionet e tyre, me një ndërhyrje shumë të rëndësishme, marrin një lloj vlere. Më pas, kur vijmë tek e drejta për përfitim, më duket sikur shtohen burokracitë për marrjen e kësaj shtese. Pika 2 thotë: “Nga data e lindjes për të drejtën për përfitim, nga data e paraqitjes së kërkesës e të tjera”. Më poshtë thuhet: “Ushton aktivitet apo nuk ushton aktivitet”. Në qoftë se është shtesë, sidomos për këtë kategori, mendoj që t’u bëhet llogaritja nga instituti në përputhje me numrin e tyre dhe të pensionit që ata marrin. Kurse këtu mund të vendosim për ata që kërkojnë përfitim suplementar. Mund të jetë shumë normale që ata të kenë kohë, kërkesa. Të shikojnë edhe aktivitetet e ndryshme. Shtesa e pensionit më duket një trajtim jo realist, siç e ka emrin, për opinionin tim dhe për respektin që kam për punën e vështirë të minatorëve dhe për vlerësimin jo të drejtë të tyre në vite, por që me këtë projektligj po përmirësohet shumë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Astrit, nuk kishte ndryshim, kishte koment.

Astrit Hado – Në rregull, por për mua ndryshim është.

Arben Ahmetaj – Në rregull, propozojeni.

Astrit Hado – E thashë, pika 2: “Personat, të cilët kërkojnë të përfitojnë trajtim suplementar, si pas përcaktimit të këtij ligji, dhe pension, jo shtesë pensioni”.

Arben Ahmetaj – Cili është mendimi i ministrisë?

Astrit Hado – Në pikën 2 të nenit 7 flitet jo për shtesa, por për pensione dhe unë po përdor termin e parakohshëm. Fakti që u ulet mosha e daljes në pension naftëtarëve dhe metalurgëve me 5 vjet dhe minatorëve me 10 vjet, kjo do të thotë që të gjithë ata, që punësohen gjatë kësaj periudhe, nuk kanë të drejtë...

Arben Ahmetaj – Ju jeni kundër ndryshimit?

Astrit Hado – Po.

Arben Ahmetaj - Sugjeroj që të ndjekim logjikën e ministrisë.

Kush është dakord me propozimin zotit Xhelilaj? Kundër? Abstenim?

Nuk miratohet propozimi i zotit Xhelilaj.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Për teknikë legislative, sugjeroj të vendosen numrat para tre paragrafëve të fundit, pra para paragrafëve 3, 4 dhe 5. Kush është dakord me ndryshimet?

Antoneta Dhima – Kam një pyetje për përfaqësuesit e ministrisë.

“Kontributi nuk mund të caktohet nën një pagë minimale dhe mbi një pagë maksimale”, pse një? Nën pagën minimale dhe nën pagën maksimale.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, Astrit!

Astrit Hado – Po, do ta rregullojmë.

Arben Ahmetaj - Në rregull.

Atëherë, me këtë saktësim, që i bëri zonja Dhima dhe me sugjerimet e mia, kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9 “Përjashtimi nga tatimet”. Përfitimet nga ky ligj nuk tatohen.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

A ka ndonjë gjë për nenin 10? Nuk ka.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11 “Të drejtat e njohura”. Gjithandej bie presja.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Urdhëroni, zoti Beqiraj!

Ismet Beqiraj – Te neni 11 “Të drejtat e njohura”, te pika 2 thuhet: “Të shfuqizohen në ligjin nr. 8/2017 për statusin e punonjësve të industrisë së naftës dhe të gazit, neni 2, pika 1, nenet 9 dhe 10 e të tjera”. Pra, shfuqizohen gati 5 nene nga statusi, të cilat janë marrë pothuajse gati pa asnjë ndryshimin dhe janë te projektligji që po diskutojmë, ndërsa pika 1 e nenit 2 shfuqizohet. Në qoftë se do ta krahasojmë me pikën 2, të nenit 2, ku ne më parë kemi hequr uzinat mekanike të naftës dhe institutet e gjeologjike e teknologjike, te pika 2 nuk është

pasqyruar ndryshimi i vijës logjike të ligjit. Mos duhet bërë ndryshim edhe te kjo pikë e ligjit, që është në fuqi?

Arben Ahmetaj – Cili është mendimi i ministrisë?

Astrit Hado – Ndryshimi i pikës 1, të nenit 2 të ligjit 8 është bërë, sepse ky projektligj, në fakt, nuk trajton vetëm naftëtarët, por përfshin 3 profesione.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ismet Beqiraj – Pika 2 e nenit 2 të ligjit është në fuqi...

Arben Ahmetaj – Është në fuqi, por tani këto rrëzohen.

Ismet Beqiraj – Nuk është rrëzuar, është rrëzuar vetëm pika 1.

Arben Ahmetaj – Ju lutem, konsultohuni që ta sqarojmë tamam!

Ismet Beqiraj – Ju lutem, është rrëzuar vetëm pika 1 e nenit 2!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit që më dhatë të drejtë!

Arben Ahmetaj – Qëndrimi juaj?

Astrit Hado – Deputeti ka të drejtë dhe do ta rishikojmë bashkë me sekretarinë.

Arben Ahmetaj – Të rishikohet bashkë me sekretarinë!

Faleminderit, zoti Ismet!

Neni 11 votohet me ndryshimin që propozoi zoti Ismet dhe që do të rakordohet midis ministrisë dhe sekretarisë.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12.

Urdhëroni, zonja Mesi!

Senida Mesi – Nuk e di nëse mund të bëhet ndryshim, por, faktikisht, kam një koment për ministrinë dhe për zotin Hado. Të gjitha këto kalkulime dhe llogaritje, sigurisht që është kompetencë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për t'i bërë, por nuk e di nëse mund të shkruajmë këtu në ligj që brenda një periudhe 1, 2 apo 3 mujore vetë Instituti i Sigurimeve Shoqërore të bëjë disa përllogaritje dhe në faqen e publikuar të informacioneve të brendshme për këto 3 kategori të ketë disa shembuj orientuese në lidhje me mënyrën e përllogaritjes apo të ketë skema apo tabela, sepse ky ligj bëhet shumë i vështirë dhe i pakuptueshëm për të gjithë përfituesit e këtyre 3 kategorive. Nuk e di nëse mund të bëjmë një sqarim jo në ligj, por t'ia lëmë detyrë Institutit që të bëjë një përllogaritje të tillë.

Arben Ahmetaj – Në rregull!

Sa për dijeni, në eksperiencën time me të tria kategoritë, ata e bëjnë llogaritjen në mënyrë spektakolare dhe më mirë se ne. Megjithatë, në ligj nuk mund të futim shembuj, por në punën e përditshme instituti dhe ministria mund t'i futin në *websait-et* e tyre apo edhe në eventet e ndryshme.

Neni 12.

Antoneta Dhima – Kam një sqarim për përfaqësuesit e ministrisë. Aktualisht për të gjithë naftëtarët, të cilët dalin në pension dhe plotësojnë kriteret e ligjit, dokumentacioni vjen në ministrinë tuaj dhe kthehet te zyra e sigurimeve shoqërore. Do të vazhdojë kjo procedurë apo individët, të cilët plotësojnë kriteret e ligjit, do t'i dorëzojnë direkt dokumentet te sigurimet shoqërore?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Urdhëroni!

Astrit Kuka – Në lidhje me procedurën për marrjen e statusit, do të vazhdojë e njëjta procedurë, sepse statusi ka vlera edhe për punë të tjera shëndetësore, për trajtim financiar të veçantë. Ndërsa për sa i përket pjesës së sigurimeve shoqërore, ato bëhen automatikisht, sepse nuk ka nevojë për lëvizje. Për statusin duhet të bëhet e njëjta procedurë.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të pyetjes që unë bëra, ka rezultuar se naftëtarët e kanë marrë dëshminë dhe, kur i kanë dorëzuar dokumentet te sigurimet shoqërore, ka një mospërputhje midis viteve të punës që u ka nxjerrë komisioni, i cili funksionon pranë ministrisë, dhe dokumentacioni, të cilin sigurimet shoqërore e verifikojnë me muaj dhe me vite. Pra, çfarë do të ndodhë me këta persona, të cilët do të përfitojnë? Do të vazhdojnë përsëri ecejaket ministri-sigurime?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zoti Astrit!

Astrit Kuka – Ka raste që ka ndodhur, por të paktën në 6 muajt e fundit kryetari i komisionit të certifikimit dhe komisioni i certifikimit kanë vepruar vetëm me ato raste që i takojnë vendimit nr. 526. Këto gjëra kanë ndodhur me ata, të cilët ishin jashtë vendimit nr. 526 dhe strukturat përkatëse nuk kishin aftësinë për të përcaktuar nëse futeshin apo jo. Aktualisht, edhe ata që janë specialistë të mirëfilltë të fushës, ende nuk po arrijnë të përcaktojnë ato raste, që janë jashtë fushës së vendimit nr. 526. Pikërisht për këto arsye Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ka filluar punën paraprake për përgatitjen e pasqyrës nr. 2, që është shtojcë e vendimit nr. 526, sepse janë ndërruar emërtimet, profesionet, është futur teknologjia e re dhe punonjësit e sigurimeve shoqërore nuk i kanë të qarta këto gjëra dhe as nuk mund t'i kenë.

Kështu që vendimet e 6 muajit të fundit i kanë eliminuar kërkesat, që janë jashtë vendimit nr. 526. Për shembull, për fillrojtësit kemi thënë jo dhe kemi pasur përplasje, sepse ky nuk është të vendimi nr. 526. Mund të jetë te statusi, por do ta shikojmë si do të procedohet më vonë. Kjo i eliminon shumë përplasjet që kanë qenë në fillim. Aktualisht, me këtë qartësohen njerëzit, sepse do të ketë edhe një vendim shtesë. Kështu që mendojmë se nuk do të ketë probleme.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Besoj se u sqaruat zonja Dhima? Në rregull.

Kush është dakord me nenin 12? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13 “Kërkesa për përfitim”.

Senida Mesi – Zoti Ahmetaj, në kuadër edhe të asaj që kemi punuar së bashku në lidhje me përmirësimin e ofrimit të shërbimeve, dua që neni 13 “Kërkesa për përfitim” ta përfshijë edhe konceptin e ofrimit të shërbimeve jo vetëm në Agjencinë e Sigurimeve Shoqërore, por në një koncept më të gjerë të agjencive, ku ofrohet shërbimi i sigurimeve shoqërore, pasi në disa bashki është edhe ADISA, nesër mund të jetë një institucion tjetër. Paraqitja e kërkesës aktualisht mund të jetë vetëm në formë fizike, por në një moment të caktuar, sikurse e përcakton edhe ligji, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave apo rregullores së ISSH-së, mund të jetë një kërkesë edhe në formë elektronike. Gjithsesi, ne e parashikojmë këtë ligj, më pas do të jetë rregullorja juaj që, në një moment të caktuar, mund ta lejojë apo jo në versionin elektronik paraqitjen e një kërkesë, në varësi të rregulloreve dhe kushteve tuaja të brendshme. Sugjerimi im për ndryshimin e nenit 13 është: “Përfitimi, sipas përcaktimeve të këtij ligj, jepet me kërkesën e të interesuarit në formë fizike apo elektronike, i cili e paraqet atë pranë agjencive të ofrimit të shërbimit të sigurimeve shoqërore”, të tjerat të mbeten siç janë.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni, zoti Kuka!

Astrit Kuka – Jam dakord me këtë formulimin, por dua të them që ta rishikojmë si e kemi te ligji nr. 7703, që të kemi një unifikim dhe jam plotësisht dakord.

Arben Ahmetaj – Përderisa u referohemi përcaktimeve të vendimit Këshillit të Ministrave dhe rregulloreve të ISSH-së, praktikisht është e gjerë, jemi brenda dhe nuk kemi nevojë të bëjmë përcaktimet e tjera. Më pas se çfarë bëni ju në punën tuaj, është puna juaj e përditshme. Ne atë derregullim, që ka drejtuar zonja Senida, duke përfshirë edhe Institutin e Sigurimeve Shoqërore, patjetër që janë të përfshira dhe nuk kemi nevojë për përcaktime në ligj, sepse nuk kemi përcaktime në asnjë ligj. Ato përcaktohen me rregullore dhe me vendime të Këshillit të Ministrave.

Faleminderit!

Urdhëroni!

Astrit Hoda – Jam dakord që të mos ngelet vetëm pranë agjencive të sigurimeve shoqërore, sepse aktualisht funksionojmë të dubluar. Pra, në ato rajone që e ka marrë ADISA, është kjo e fundit, kurse në rajonet që nuk ka ADISA...

Arben Ahmetaj – Pra, këtu duhet futur mendimi i Zonjës Mesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, “edhe pranë agjencive që ofrojnë shërbime për qytetarët”.

Astrit Hoda – Ne këtë ndryshim e kemi bërë te ligji nr. 7703 dhe mendoj të ruajmë të njëjtin përkufizim, siç është....

Arben Ahmetaj – Është bërë ndryshimi në ligjin bazë, megjithatë e shtojmë, se nuk ka gjë.

Kush është dakord me ndryshimet e bëra në nenin 13? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14 “Aktet nënligjore”.

Ismet Beqiraj – Edhe tek amendamenti që kam bërë në lidhje me aktet nënligjore, ashtu siç e miratuam ligjin me procedurë të përsheptuar (nuk kanë pse rrinë 3 muaj, 4 muaj, 5 muaj apo 6 muaj), unë kam propozuar që, në vend të fjalëve “brenda 3 muajve”, të bëhet “brenda 2 muajve”.

Arben Ahmetaj – Bie dakord me propozimin e zotit Beqiraj.

Kush është dakord me ndryshimet e bëra në nenin 14? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, zoti Astrit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se do ndihmë, ashtu siç kemi shkruar ligjin bashkë, vij unë dhe t’i shkruaj vendimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e ka vetëm energjetika, por ti, sepse, praktikisht, logjika e Ministrisë së Financave ka vendosur balancën. Megjithatë, nuk po i hyj fare këtij detaji.

Neni 15 “Hyrja në fuqi”. “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”.

Kush është dakord me nenin 15? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord me projektligjin në tërësi? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit! Urime të tria kategoritë!

Maxhoranca sapo mbajti një premtim shumë të rëndësishëm për metalurgët, për minatorët dhe për naftëtarët.

Faleminderit të gjithëve!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti